



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 17

Datë: 23. 05. 2017, ora: 16:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Nenad Rikallo, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

- Shqyrtimi i procesverbaleve Nr. 12, 13, 14/2017

2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor;

3. Aktivitetet e ZRPP-së

Rekomandim për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatet e tyre, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës.

4. Raport i Këshillave të KQZ-së

a. Këshilli Për Buxhet

Shqyrtimi i kërkesës për transferin të mjeteve nga programi i zgjedhjeve;

Shqyrtimi për mbushje të telefonisë mobile gjatë procesit zgjedhorë;

5. Shqyrtimi i rekomandimit të DOZ-it për rritjen e numrit të votuesve në vendvotim

6. Të ndryshme

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KOZ-së

Valdete Daka: Mirë se keni ardhë. A ka dikush ndonjë propozim për këtë rend dite? Ndonjë pikë shtesë?

Ercan Spat: Faleminderit, kryetare! Unë pata, më të ndryshme, jo si pikë, në lidhje me disa probleme në lidhje me organizimin në një qënder të votimit në Prizren. Mos të them me hy në detaje.

Enis Halimi: Nuk jam krejt i sigurtë që ka nevojë që me urgjencë të shqyrtohen, por megjithatë është mirë që në mbledhje të futet ftesa për nomimin të këshillave të vendvotimeve, dhe procesi i mbikqyrjes së shtypjes së fletëvotimeve. Por nuk janë, ndoshta, çështje që kanë urgjencë, dhe megjithatë janë gjëra munden me pritë deri nesër. Atëhetrë, si t`a shihni të arsyeshme, mund t`i procedoni sot, ose nesër.

Valdete Daka: Nëse bën, s`e e kemi të ngarkuar pak rendin e ditës? Bën edhe nesër. S`e ne çdo ditë mbajme mbledhje. Po!

Adnan Rrustemi: Në lidhje me këtë çështje, unë sugjeroj që me mbajtë një mbledhje këshilli i operacioneve zgjedhore, nëse ka gatishmëri, dhe me percaktuar s`e ka disa çështje që duhet me i fiksuar para se me i dërgu festën për nominime.

Valdete Daka: Atëherë, kush është për këtë rend dite?

Betim Gjoshi: Kryetare, të njoftohemi s`e janë duke i shtypur materialet e pikës së tretë, me e hedh në të tetën.

Valdete Daka: D.m.th. aktivitetet e ZRPP-së me dalë e fundit para pikës t`ndryshme. Atëhere, kush është për këtë ndryshim? Faleminderit! Vazhdojmë me pikën e parë. Ato janë procesverbale të mbledhjeve 12, 13 dhe 14. A ka dikush vërejtje në këto procesverbale? Sugjerime...? Urdhëro...!

Nenad Rikallos: Në fillim të fjalimit tim, jam i cituar mirëpo, më vonë konteksti i fjalës sime nuk është dhe, duket i ndryshuar dhe nuk është i qartë. Më vjen keq, por unë nuk mund t`a miratojë...

Valdete Daka: Me vërejtjet e Rikallos dhe Bajramit, le të bëhen plotësimet në procesverbale..Kush është për miratimin e tyre...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalet me një votë kundër (Nenad Rikallo).

2. Aktivitetet e sekretariatit lidhur me procesin zgjedhorë

Enis Halimi: Faleminderit kryetare. Sekretariati, me angazhimin e vet, në vijë mësi është duke përmbushë obligimet dhe detyrat e veta, që dalin, qoftë nga rregullativa ligjore, qoftë nga planet operationale të caktuara. Pas pranimit të ekstraktit të regjistrimit qendror civil, divizioni i shërbimit ka bërë caktimin e votuesve në qendrat e votimit. Lista preliminare e votuesve përmbanë 102 693 votues më shumë se në zgjedhjet e vitit 2014. Sipas planit operacional, makina kërkuese dhe operacioni për ndërrimin e qendrës së votimit janë publikuar në orën 12 të datës 19 maj, dhe nga ai moment, një numër i madh i votuesve kanë kërkuar që të bëjnë ndërrimin e qendrës së votimit. Risi në këto zgjedhje, është mundësia që online të bëhet kërkesa, përkatësisht ndërrimi i qendrës së votimit. Dikund deri tash, që po flasim, janë rreth 2500 aplikime online, për ndërrimin e qendrës së votimit, dhe në mënyrë sistematike janë duke u verifikuar secili votues potencial që aplikon për ndërrimin e qendrës së votimit. Për zgjedhjet e parakohëshme për Kuvendin e Kosovës do të kenë mundësi të votojnë 156 031 votues të ri, prej tyre 118000, që pas zgjedhjeve të vitit 2014 kanë mbushur moshën 18 vjeçare dhe që do t'i mbushin 18 vjet deri me datën 11 qershor 2017. E, poashtu 37 718 të regjistruar për herë të parë, dhe votues që kanë marrë dokumentet e Republikës së Kosovës pas zgjedhjeve të vitit 2014. 33 542 emra të votuesve janë larguar, pra prej zgjedhjeve të vitit 2014 dhe deri tash janë larguar pra nga lista 33 542 emra. 19 796 emra të votuesve janë larguar për arsye s'e ata tashmë kanë hjekur dorë nga shtetësia.

Si rezultat i krijimit të qendrave të reja të votimit, tha z. Halimi, divizioni i shërbimit të votuesve ka caktuar 84 510 votues nëpër këto qendra. Për sa i takon votimit jashtë Kosovës, deri me datën 22 maj, përmes email-it të, ne kemi pranuar, përmes email-it dhe përmes postës janë pranuar 11818 aplikacione, të cilat i keni të shpërndara sipas shteteve, në tabelen që keni para jush. që të mos i'u lodhë me leximin e tyre, nga secili shtet. Për sa i takon statusit të aprovimit për aplikacionet janë pranuar përmes e-mailit, kemi këto të dhëna 6.857 votues, aplikacione janë të aprovuara, 1.131 kanë statusin e fillestarit të refuzimit dhe 27 aplikues nuk kanë status të vlersimit për këto raste do të bëhet kontrollimi i dokumenteve dhe materialeve dhe ato eventualisht do të mund të rikthehen në rivlersim. Sa i përket totalit që janë proceduar dhe vlerësuar në shifrat e lartpërmendura nuk janë të futura aplikacionet të aplikuesve nga Serbia dmth që kanë arritur në formën postare të KQZ-së në ditën e djeshme pra brenda afatit të përcaktuar në plan operacional me datën 22 maj 2017 po ashtu i kemi edhe disa raste të cilat mundë t'i shihni edhe në raport, që të mos ju lodh më shumë, kisha me thënë eklatante në kuptim të aplikimit me e-mail të cilat i kemi ne si shërbim votues. I kemi evidentuar dhe i keni në rastin e pare, ku i keni në një e-mail me 13 aplikacione. Në rastin e dytë me 113 aplikacione një e-mail me 100 aplikacione dhe një rast i katërt me 700 aplikacione me persona që kanë dmth me mbiemra të ndryshme. Për sa i takon trajnimit, dje dhe sot është mbajtur programi i ashtuquajtur orjentues dhe njoftues i komisioneve komunale të zgjedhjeve. Pra trupat menagjues të zgjedhjeve të nivelit të dytë të cilët i kemi emëruar para disa kohe. Edhe poashtu tash edhe si pikë e fundit e rendit të ditës i keni disa që kanë hequr dorë, apo për arsye të ndryshme kanë hequr dorë, apo i kanë zëvendësuar i keni kërkesat e ndryshme aty që do t'i procezonin dhe si ti rrimëroni tjerë. Për sa i përket dimensioneve të tjera si kundërqë është Qendra e Numrimit të

Rezultateve, ajo po fillon, vazhdon me parapërgatitjet, që të jetë sa më e përgatitur gjatë, atëhere kur, sipas planeve operacionale e ka gabimin e vet kryesor. Dhe poashtu, edhe pjeset tjera në sekretariat janë të gjitha duke i zhvilluar aktivitetet e tyre, që të arrijme t'i kemi të gjitha materialet dhe të gjitha procedurat në kohën optimale. Në faqën e fundit e keni edhe një pjesë të aktiviteve që kanë të bëjnë me kontrata dhe aktivitete prokuruese buxhetore, të cilat jemi duke i procesuar, dhe nëse gjithçka shkon sipas planeve, atëhere do të mund në kohë optimale t'i kemi të gjitha materialet e nevojshme për këtë process zgjedhorë. Faleminderit!

Valdete Daka: A ka dikush pyetje për kryeshefin? Po, urdhero Adnan...!

Adnan Rrustemi: Faleminderit! Përshëndetje të gjithëve! Faleminderit kryeshefit për këtë raport, që prezanton aktivitetet e ndërmarrura të sekretariatit për përgatitjen e zgjedhjeve të 11 qershorit. Unë i kam disa pyetje, dhe natyrisht, disa sqarime, në lidhje me disa prej aktiviteve. E para. Po me intereson, në fakt është e domosdoshme, që lidhet edhe me çështjen që e ngriti kryeshefi si propozim , për t'u futur si pikë e rendit të ditës. Na duhet numri i vendvotimeve për çdo qender të vendvotimeve, për çdo komunë, sa më parë që është e nevojshme. Është duhet edhe partive politike për planifikimet e tyre të numrit të komisionereve që do t'i nominojnë. Aq më tepër që ne kemi themeluar një numër të konsiderueshëm të qendrave të votimit vitin e kaluar. Kjo, e kam thënë edhe herën e kaluar, e bën të pamundur që të mirret si referencë, qoftë edhe si mesatare, numri i vendvotimeve të vitit 2014. Besoj që, më se largu nesër, e kemi këtë informacion fillestar, se sa vendvotime i kemi në nivel vendi, të shpërndarë për secilën qendër të votimit në secilën komunë. Çështja e dytë që lidhet, është me periudhën e shërbimit votues. Me votuesit që kanë kërkuar ndryshimin ose ndërrimin e qendrës së votimit. Është mirë që po funksionon ky aplikacioni online, dhe i'a lehtëson votuesve ndërrimin e qendres së votimit. Megjithatë, unë e kam një pyetje teknike, por që më duket që është e rëndësishme për votuesin. A merr votuesi përgjigje nga sekretariati? Konfirmim ose refuzim, varësishtë prej gjëndjes së kërkeses së tij? Normal, në rastin kur bën ndërrimin automatik të qendrës së votimit. Është me shumë rëndësi kjo, s'e njerëzit munden me konsideruar që në momentin kur aplikojnë me ndërru qendrën e votimit i'u ka ndryshuar, në ndërkohë ka mundësi që i'u është refuzuar, sikurse nuk janë edhe të sigurt, edhe a i'u ka ndryshuar qendra e votimit për sa kohë që nuk marrin përgjigje.

Një çështje tjetër, tha z. Rrustemi, mbase edhe antarët e tjerë kanë marrë feedback, po them, nga akteret tjerë, ka të bëjë me komisionetret. Që lidhet me përshtatshmerinë e kandidateve për komisioner, respektivisht me një aspekt që ka të bëjë me personat, qytetarët tanë që janë në skema sociale dhe të kategorive të ndryshme të luftës, të cilëve ne zgjedhjet e Drenasit, për shkak të angazhimit si komisioner i'u është ndalë paga mujore, ose asistenca sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqënies Sociale. Personalisht kam pranuar një numer të madh të telefonatave, dhe s'kam mundur t'i jap përgjigje se cila është e vërteta. Unë e di që KQZ i emron mbi bazen e kritereve tjera të ligjit, por duhet me marrë parasyshë edhe këtë aspekt, që duke e ditur që angazhimi në ditën e zgjedhjeve nuk është vend pune, as me kontratë, e as me pagë. Është një angazhim mbi bazen e shërbimeve që duhet të kompenzohet angazhimi i atyre ditëve, dhe mendoj që është e padrejtë. Dhe, nuk e di sa dhe çka kemi mundësi si KQZ me bë në raport me

MPMS, që me u siguruar që këtyre komisionerëve nuk i`u hiqet kjo pagesa e tyre mujore. E treta, ka të bëj me votuesit jashtë vendit. Nga raporti që kemi d.m.th duket, vërehet qartë ka një interesim shumë më të madh, në krahasim me zgjedhjet e deritanishme në Kosovë të mergatës për t`u regjistruar si votues jashtë vendit kjo është për tu vlersuar dhe për t`u inkurajuar që këta të votojnë në periudhën kur përcaktohet dërgimi i fletëvotimeve . Përkundër vështirësive që kam parë ç`është e vërteta nga periudha e shkurtër deri tek problemet teknike për t`i dërguar kërkesat e tyre dhe aplikacionet, dhe natyrisht përkundër që është një numër i konsiderueshëm. Ne të gjithë e dimë që nuk është i mjaftueshëm duke marrur parasysh numrin e madh që kemi të bashkëatdhetarëve jashtë vendit. Por, sa i përket votimit jashtë vendit kam dy çështje që duhet me i ngrit. Në fakt e para është që KQZ-ja, sektariati në këtë rast të merr masa që periudha e votimit për gjithë këta që janë regjistruar suksesshëm të përmbushet me efikasitet që votuesit të njoftohen në mënyrë sa ma të shpejtë të fillojnë të votojnë sa ma pare. Kur fillon periudha e votimit, se ne gjithë e dimë këtu, që po të presin këta votues të regjistruar që të pranojnë përmes postës formular, zarfat dhe materialet e tjera të nevojshme për votim, bëhet e pamundur kthimi pastaj i fletëvotimeve. KQZ-ja, sektariati me këtë rast duhet të përdorë të dhënat që i kanë tashmë në dispozicion për të formuar, që në ditën e parë kur fillon periudha e votimit. E dyta, ka të bëj me një shqetsim që lidhet me pranimin e 3.890, apo sa ishin të aplikacioneve mbremë, në orët e vona para se të përmbillet afati i aplikimit nga Serbia në mënyrë të pa sqaruar nga sekretariati, në mënyrë të grupuar do të thoja të gjitha thujse me një dërges , për mua është dërges e kundër ligjshme padyshim.

Ne, tha z. Rrustemi, të gjithë e dijmë që në bazë të ligjit, votuesi bën kërkes për regjistrim në mënyr individuale dhe si vullnet i tij, aq më tepër përmes postës ,aq më tepër përmes postës. E tepërta siç e kemi thënë dhe kemi bërë një konstatim si KQZ mund të dërgoj aplikacionet me një dërges në këtë rast me e-mail , për familjarët e ngushtë të njejtës familje. Personalisht mendoj që KQZ-ja duhet me i pezullu këto 3.890 aplikacione të ardhura nga Sërbia në mënyrë të pa sqaruar duhet të sigurohemi që në qfarë mënyre kan ardhur në Kosovë, a janë pranuar nga Posta e Kosovës në mënyrë të rregullt si dërgesa postare apo janë sjellur në Kosovë në mënyrë fizike apo aq më tepër janë mbushur ne Kosovë e janë dërguar në famë postare të KQZ-së kjo është shkelje e rënd, personalisht mendoj që duhet ti bëjmë ftes Policis dhe Prokuroris në mënyrë të veçantë me hetu këtë shpejtë aktivitet, që KQZ-ja me u siguru që këta votues janë të ligjshëm, këto aplikacione janë të rregullta dhe pastaj me ju mundësu edhe votmin nëse konstatohet që unë dyshoj, mund të konstatohet një gjë e tillë, ju faleminderit.

Betim Gjoshi: Unë, së pari e falenderoj shumë personelin, I cili është duke punuar në orë të gjata për me i`u ofru sherbim gjithë votuesve në Kosovë, në këto pak ditë që n aka lënë kushtetuta dhe ligji, për me I organize zgjedhjet. Me vjen shumë mirë që puna e tyre po shihet. T`a marr një shembull, një novacion që kanë sjellë, aplikimin për ndërrim të qendrës së votimit, edhepse afat i shkurtër. 2500 kërkesa të tilla kemi. Ne e dimë të gjithë, që kur ka qënë aspekti fizik, ka qënë numri jashtzakonisht më i vogël, kështu që i inkurajoj me marrë edhe më tutje hapa për inovacion. Pastaj, du me I inkurajuar më tutje me i`u përgjegjë edhe në zgjedhjet tjera në këtë mënyrë massive, mërgaten, votimit jashtë vendit. Duke e përfshi edhe mundësinë me

ardhë edhe ditën e zgjedhjeve me votu në Kosovë. Janë të mirëseardhur me i`u përgjegjë thirrjes me ardhë me votu. Ata janë votues të Kosovës. Të gjithë ata që janë në listë votuese.

Edhe këtu, tha z. Gjoshi, ka bërë një punë jashtzakonisht të madhe shërbimi përkatës. Ka vazhduar me bë, dhe i inkurajoj që sa më shpejtë me vazhduar me i`u kthyer përgjegje. Dhe mendoj që në këtë segment është pika e parë e reformes zgjedhore që duhet të ndërrohet shteti i Kosovës , që qytetarëve tanë qee jetojnë jasht vendit me i`a mundësu me votu atje, dhe mos me i`a lejuar asnjë lloj grupi me keqpërdorë dhe me folë ne emer të tyre. Poashtu, e inkurajoj sekretariatit me që këto 18 ditë përgatitje, sepse dita e diel nuk na takon ne, bie në duar të komisionereve të partive politike, të vazhdoj edhe me tutje me u përgatitë. E di që është duke e kry punën në presion të ndryshem, por i inkurajoj që me vazhdu edhe më tutje me u përgatitë sa më të mirë që ditën e zgjedhjeve t`a kemi tamam një ditë feste.

Binak Vishaj: Unë, e pata një propozim këtu te raporti i divizionit të sjelljeve, thot se i kemi një numër prej katër rasteve ku kemi e-maile që kanë apliku më shumë se sa është paraparë me vendim të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve duke parë parasysh teknikisht vështir qenë bukur vështirë e çashme edhe e-maili dhe faksi i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve për regjistrim. Duke parë parasysh se kemi pas edhe grupacion tjetër që ka ardhur në mënyrë kolektive për tu shqyrtu, unë propozoj KQZ-në që këto aplikacione ta udhezojnë shërbimin votues, që këto aplikacione të shqyrtohen në rast se janë votues të rregullt t`ju kthehet përgjegjia që janë në listën votuese sikurse atyre aplikantëve që kanë qenë në bazë të vendimit të KQZ-së.

Sami Hamiti: Faleminderit kryetare, ju përshëndes gjithëve. Domosdo, po hapet tema e votuesve jashtë vendit dhe aplikacioneve, sepse ditëve të fundit është e vërtet që është bërë më tepër se një kauz politike qështja e tyre se, dhe një element që dikush është më shumë e dikush me pak i interesuar që të votoj mërgata jonë. Ne kemi vendos disa afate këtu në Komision Qëndror Zgjedhorë dhe atyre afateve ju kemi përmbajtur. Realisht po e shohim tash po flasim në numrin e tanishem të aplikacioneve që kanë ardhur sa do të mund të procedohen dhe a mund të procedohen me kohë që të votojn. Prandaj mendoj që Komisioni Qëndror Zgjedhor e ka marrur një vendim, i ka marrur ato afate dhe ju ka përmbajtur atyre afateve, dhe asnjëri as tjetri këtu më shumat as më pak nuk është marrur, apo nuk ka qenë më shumë apo më pak i përkushtuar që tju dilet në ndihmë edhe në një servis mërgatës që të voton. Ato janë afate sepse jemi ne zgjedhje të jashtëzakonshme, janë afate të shkurtuara dhe nuk mund të bëhet tash një kauzë politike apo të shfrytëzohet nga kushë do qoftë dhe të sulmohet KQZ-ja në rastin që ose janë kundër kësaj ose janë kundër mërgatës ose janë subjektet e ndryshme politike kundër mërgatës se nuk ka asgjë të vërtet aty.

Sa i përket anës tjetër, tha z. Hamiti, vendimet që i kemi marr në KQZ grumbullimi i aplikacioneve në vendvotim, se kemi marr një qëndrim, ti përmbahemi qëndrimit që kemi në KQZ me e-mail mund të aplikoj njëri për antarët e familjes që i ka në adres, jo 700 aplikacione po asesi edhe në anën tjetër që tash e ngriti Adnani qështjen e 3.000 apo 4.000 klikove që kanë ardhur me postë, realisht po vendoset një dyshim se si kanë ardhur, sigurisht që sektariati e din, dhe unë konsideroj që gjdo aplikacion që ka ardhur në mënyrën e rregullt me atë, sipas vendimeve dhe qëndrimeve të KQZ-së të shqyrtohet qfarë është jashtë konditave dhe vendimeve dhe qëndrimeve të KQZ-së duhet të shqyrtohet qfarë është jashtë konditave dhe vendimeve dhe

qëndrimeve të KQZ-së duhet të hudhen. Por edhe një here po them mos të bëhet një kauzë, kauzë e rrejshme, sepse ne kemi vendos disa afate dhe të shfrytëzohet politikisht që një subjekt apo dikush në KQZ është kundër kësaj.

Ilir Gashi: Në fakt, partitë politike munden të bëjnë kauza politike, por nuk është e ndershme që KQZ-ja të takohet për interesa të subjekteve politike. Subjektet politike, duhet t'a dinë që kur kërkojnë zgjedhje të jashtëzakonshme, edhe proceset pastaji i kemi të jashtëzakonshme. Ne kemi miratuar disa afate me të cilat të gjithë antarët e KQZ-së janë pajtuar, që ato afate të drejta, dhe askush nuk ka kërkuar që në Kohën e duhur që të kemi afate shtesë. Mendoj që loja me mërgatën është e pandershme, aq sa është e pandershme edhe atakimi që i bëhet KQZ-së për këtë çështje. Ne, unë personalisht, dhe shfrytëzoj rastin të përshendes edhe të gjithë ata që kanë punuar deri në orë të vona që të i'u përgjegjen kërkesave të mërgates, në mënyrë që ata të ushtrojnë të drejtën e tyre ligjore për të pasur të drejtë me votuar. E thanë edhe parafolësit. Lutemi që ata të shrytëzojnë këtë të drejtë sa më shumë dhe më shpejtë që është e mundur, dhe në të njëjten kohë të jemi të kujdesshëm sepse, kur kërkohet që të kemi procese të jashtëzakonshme, të jemi të mirëkuptueshem edhe për afatet tona pastaj, të cilat ne i kemi aprovuar.

Adnan Rrustemi: Së pari, sa i përket çështjes së këtyre dy kategorive, ose dy rasteve që i kanë derguar nga një email i vetëm. Njëri 100, tjetri 700, është e vertetë që ne si KQZ, kemi bërë një lloj konstatimi, mund të konsiderohet vendim, që aplikacionet dergohen nga një email I vetem për antarët e familjes së njëjtë. Kjo u bë edhe si njoftim public për votuesit, dhe I kemi orientuar, çështje e verteta, votuesit të operojnë në këtë mënyrë, megjithatë unë kërkoj nga sekretariati që këto dy raste t'i trajtoj në mënyrë specifike, dhe të na sjellë një informacion më të detajuar për çfarë bëhet fjalë? Për çfarë aplikacione? Duhet një lloj hetimi te brendshem duhet me bë. Pastaj, mendoj që KQZ duhet me marrë një vendim meritorë për këtë, duke mos i'a cenuar të drejtën asnjë votuesi që të përfshihet në process zgjedhorë. E dytam sa i përket këtyre 3 890 aplikacione të ardhura nga Serbia, ne kemi pas, në mënyrë sporadike, raporte nga sekretariati për numrin e aplikacioneve që kanë ardhur për tu regjistruar si votues jashtë vendit, ne e dimë përafërsisht që në raportin e parafundit e kemi pasur një shifër prej 10 ose 12 mund të gabohem apo 6 të aplikacioneve që ishun pranuar në mënyrë t'ërregullt nga Sërbia dhe papritmas në fund të ditës mbrëmë në orë të vona vijnë 3890 aplikacione edhe është për të ardhur keq që diskutimi nuk po orientohet mbi ligjshmërinë dhe vërtetësinë e këtyre aplikacioneve dmth ne duhet të shqetësohemi dhe kjo është për mu aka prapavi kriminale në këtë dërgesë dmth duhet të dihet qart kush I ka sjell këtu në Kosovë gjëja e parë e papranueshme është që ta dërgoj një person komplet aplikacionet për një trup të caktuar votuesish dmth aq më tepër përmes postës dmth nëse u nënkuptua përmes e-mailit që lejohet deri në një numër të caktuar kjo është nënkuptuar që është kanal e-mail I dërgesës, por jo posta në një pako të vetme me 3890 aplikacione sepse nuk I dimë as detajet kështu në tërësi dmth këtu duhet të ftohet mu hetu se këtë nuk mund e bënë as sekretariati as KQZ-ja, shërbimi votues ne këtë rast sekretariati është shku në fa postarë dhe në gjendjen që e kanë gjetë i kanë marrë i kanë sjell në KQZ, por ne duhet ta dimë si KQZ kush i ka vendosë ne fa postar, nga kanë kaluar ato, a ka pasur transit ndërshteteror normal të domosdoshëm ligjor dmth kjo duhet mu hetu dmth unë personalisht do ta ndjekim këtë qeshtje

sepse ne nuk mund ti votojimë si të tilla, unë s`po lëshohem fare në përmbajtjen e këtyre dokumentacioneve sa që hapja e kësaj pako do të na zbardhë shumë të vërteta edhe për saktësinë e këtyre aplikacioneve, e treta sa i përket afateve dhe mërgatës, po është për t`avlersuar punën e sekretariatit por ne të gjithë e dimë që kemi përgjegjësi institucionale dhe profesionale dhe detyra të caktuara që na jepë ligji, madje paguhemi për këtë prej zyrtarit më të ulët deri të zyrtari më i lartë nuk jemi këtu vullnetarë mbi bazën e së cilës angazhohemi aq sa duam dhe atëherë kur duam, ne kemi përmbushur komplet aktivitetin i cili na parashtrohet neve, e para është e vërtetë që I kemi përcaktuar afatet është e kemi votu planin operacional, por është edhe një gjë e vërtetë që është në përgjegjesi të KQZ-së ti vlersojë aktivitetet dhe kudo që ka hapësirë e që nuk e cenon aktivitetin tjetër ti zgjasë afatet ti ndryshoj nuk janë ato të pandryshueshme dmth nëse KQZ-ja nga një parim që ja ka rendit vetës edhe ne planin strategjik për të qenë në shërbim të palëve, të votuesve, të akterëve, në këtë rast të subjekteve politike, atëherë ne edhe mund t`a vlersojmë a ka nevojë, a ka mundësi të zgjatet afati, a jo?

Personalisht, tha z. Rrustemi, e vlerësoj që ka pasur hapsirë, nëse jo 3 ditë, ka pasë hapsirë 2, ose së paku 24 orë. Dhe atë, nëse jo për tjetër, për t`i kompenzuar ata votues të cilët janë demtuar për shkak të resurseve tona, për shkak të kapaciteteve tona. Sepse, kur t`a zhvillojme një aktivitet si institucion, ne nuk mund të themi, edhe e kam thënë edhe me heret, ne e kemi këto kapacitete, dhe tashmë të tjerët aktivitetet t`i përshtatet kapaciteteve tona. Nuk janë kapacitetet tona konstantja. Janë shërbimet tona. Ne duhet me i ndryshuar kapacitetet tona. Duhet me i shtuar. I kemi pasë dy email zyrtar, se i kemi referu praktikës së mëparshme se mjaftojne, ose zgjedhjeve të rregullta, sepse janë edhe kanallet tjera me faks ose me postë me dërgu aplikacionin, por pas dy ditëve, kur u pa që dy emaila nuk e përballojnë dot interesimin e mërgates, nuk mundesh me isistuar që mos me hapë edhe emaila tjerë. Duhet me pasë parasyshtë këtë. Madje edhe emailat personal zyrtarë, që i kanë zyrtarët ish dashtë me i vu në funksion. A je tash në shërbim, a jo? Çfarë faji ka mërgata, nëse i kthehet 20 emaili për shkak të kapacitetit të emailit që nuk ka hapsirë me u pranë. Këtë duhet me diskutuar. Kemi pasë, në raste tjera dhe në ditë të tjera për me vlerësu, dhe mbase, edhe me nxjerrë përgjegjësinë. Mërgata keqpërdoret duke e pamundësuar të drejten e tyre për me votuar. Pikërisht keqpërdorim i mërgates është kur ti e fton me votu dhe ndërkohë i`a bllokton mundësinë për me votuar. Ky është keqpërdorimi i mërgates. Edhe një gjë. I kuptoj procedurat e prokurimit. Nuk kemi bërë asnjë aktivitet të informimit publik, përjashto një informimi që kemi vendosë ne RTK. Madje as rrjetet sociale që i kemi.... Nuk kemi bë asnjë aktivitet të informimit publik për votuesit, madje as në rrjetet sociale tona të KQZ-së nuk i kemi përdorë. Kjo është papërgjegjësi totale e institucioneve...

Ilir Gashi: s`është e vërtetë...

Valdete Daka: Vetem pak, ju lutem! Tashmë, kemi kaluar në fjalime politike dhe fushatë zgjedhore. Në qoftë se e përdorim këtë vend për fushatë zgjedhore, atëherë po e shpallim edhe ne fushatën zgjedhore, dhe po dalim të gjithë po bëjmë fushatë. Ju lutem! KQZ-ja i ka shfrytëzu të gjitha mundësitë ligjore dhe kushtetuese të cilat i ka për me ia ofru mërgates të gjitha mundësitë për me votu. Ne, tha znj. Daka, përkundër faktit që me ligj është e paraparë që mundësia për aplikim është vetem me postë dhe me faks, ne kemi mundësu edhe me email, e cila nuk është e paraparë me ligj, por ne vetem për të i`a mundësuar... rregullat janë...aktet nënligjore të cilat të

cilat ne me vullnetin tonë i kemi bërë. Po them, vetëm për me i`a mundësuar mërgates që të aplikojnë për regjistrim. Dhe, t`lutesh më shumë se keqpërdoret foltorja e KQZ-së për qëllime politike të askujt. Ne, i kemi bërë të gjitha çka ka qënë e mundur teknikisht dhe fizikisht. Ne, prej lekurës tonë s`mundemi me dalë...! Krejt çka ka qënë e mundur me u bërë për mërgatën është bërë... Dhe, tash mërgata keqpërdoret për çështje politike të kujdoqoftë.

Nenad Rikallo: Ne, qysh prej fillimi, kemi treguar se kjo çështje mundet me qenë problem serioz, sepse jo vetëm që afatet janë të shkurtëra që janë vendosur, por ne jemi obliguar me këto afate kur janë shpallur zgjedhjet. Edhe procedurat, si aplikohet dhe si votohet...Unë, jam i pakënaqur..., sepse, dihet se çka janë normat ligjore...Unë e di cka janë normat, por nuk do të flas politikisht sepse kam shumëçka për të thënë...Por unë kam problem serioz, sepse afatet tona të caktuara, vështirë se mund t`ia mundësojnë votuesit që të kryehen këto procedura deri më 1 qershor...Këtë fletëvotim nuk do ta miratojmë as listen votuese finale përfundimtare sepse, të gjithë do të kenë problem që ta kthejnë me postë...Njoftimi për votues, unë nuk kam përgjigje se, aplikacionet nuk kanë mbërri në destinaciet e duhura...në asnjë adresë, as në Beograd dhe ky sistem teknik është shumë i ngadaltë, dhe unë pyes se qysh do të kthehen këto aplikacione, qysh do të futen në sistem...Ka procedura: qysh dërgohen, dhe qysh kthehen...Mos përpiqeni të fitoni poena politik..Dje ka qenë dita e fundit që të dërgohen, dhe mos të mohohet e drejta, mos të kushtëzohet...

Valdete Daka: Nenad! Shërbimi i votuese, do t`i shqyrtoj secilin aplikacion edhe secilën dërgesë që është dërguar me e-mail apo me faks dhe vetëm pasi ti shqyrtojn se a i përmbush të gjitha kriteret ligjore, do ti aprovoj, ne ende po flasim për aplikacionet të cilat nuk janë vërtetuar dhe as nuk janë verifikuar...

Sami Hamiti: Është mirë që ne, them mos me bo politik por, çështjet funksionale dhe afatet që janë vendosur këtu nuk janë politike, pakënaqësia e zotërisë Rikarillo ka qenë këtu kur i kemi vendosur ato afate, dhe këto janë zgjedhje të jashtëzakonshme, tash nuk mund të ndodhë asnjë diskriminim, është bërë dhe se është vendosë për të gjithë diasporën njësoj për votimin jashtë vendit. Kemi vendosur edhe për pjesën tjetër afatet kanë qenë të njejtja ai mundet me qenë i pakënaqur sepse afatet, por edhe një, do si do edhe zotit Rikallo edhe gjithëkujt, viti 2013 kur kanë ardhur të mbushura kutitë me të njejtin kimik mo nuk kanë mu nda sugurisht kështu që dijeni atë punë, edhe e dyta, nëse ka mundur dikush të aplikoj 700 herë zoti Rustemi kanë mundur edhe të tjerët me apliku deri në ditën e afatit që është. Faktin që i kemi përcaktuar me e-mail po kanë qenë njerëzit që kanë mundur dhe kanë aplikuar në qdo kohë kur kanë ardhur njëra prej adresave hapur ka qenë, se unë jam marr me atë punë siq je marr edhe ti po, kaq, këto janë afatet, unë edhe një herë po them le te shiqohen secila nëse kanë ardhur të grupëzuara kemi marrë një vendim që nuk trajtohen dhe nuk do trajtojm fare, tash mund të themi kemi dhënë nga e-maili kaq kemi vendosue kaq, tash pot hemi se ditët kanë shkuar njërezit po grumbullohen dhe i dëgojnë 700 aplikacione, edhe i dëgojnë edhe 100 këtej vendosen me ardhë edhe 4-5 mijë është kryer afati ky është le të procedohet me rregullat dhe vendimet që I kemi marr në KQZ.

Eshref Vishi: Ne, si duket ende jemi në pikën e dytë lidhur me raportin e kryeshefit të ekzekutivit të sekretariatit për aktivitete të sekretariatit në procesin zgjedhor, unë po ndërlidhem me tëmën që u diskutua nga kolegët e mi ku dihet se aktiviteti me vëllim i këtyre ditëve ka qenë pranimi aplikimeve për votim të votuesve jashtë vendit. Administrata, ka qenë e stërngarkuar në këtë process, por ne jemi të obliguar të krijojmë mundësi votimi për të gjithë votuesve mirpo gjithënjë në bazë të procedurave ligjore.

U përmend, tha z. Vishi në raportin e kryeshefit të ekzekutivit pranimi i dërgesave me postë nga Serbia një grumbull të tyre këtu, unë mendoj që në rradhe të parë administrata duhet ti përfill procedurat ligjore që i ka para vetes, në rradhë të dytë neve si anëtarë të komisionit qëndror zgjedhorë duhet të na sjellë më shumë informacione se një raporë me një numër fiks të kaq aplikimeve të cilat janë adresuar në komisionin qëndror të zgjedhjeve unë mendoj se mbi bazen e informacioneve që do ti kemi nga raporti që duhet të sjellë administrata dhe sekretariati ne duhet të procedojmë më tutje.

Bika Vishaj: Filimisht, puna e afateve është e përcaktuar me rregull të KQZ-së. Ne, kemi një rregull që është përcaktuar me afatet ne zgjedhjet e parakohëshme, dhe ato nuk mund të ndryshohen. Sa i përket kërkeses time për shqyrtim të këtyre aplikacioneve, të gjithë po pajtohem që kemi pasur vështirësi teknike për të aplikuar. Edhe pse vazhdimisht kane ardhë emaila, kanë ardhë në fakt kërkesa për regjistrim. Këta njerëz kanë aplikuar Brenda afatit ligjor. I ka jap mundësia me pasë qasje në emailin zyrtarë të KQZ-së. Në momentin kur i'u ka japë mundësia, atëherë e kanë shfrytëzuar për t'i bërë krejt aplikimet për shkak se e kanë pasur të pamundshme të pamundshme edhe një herë me pasë qasje në email për të aplikuar. Kështu që, të gjithë po thojmë, në njëfar forme se afatet janë kanë të shkurtër, dhe mos i kemi hyrë në hak diaspores. Po them që ne e kemi një mundësi, që bile ata që kanë aplikuar brenda afatit ligjor, e qe I kemi kërkesat e tyre të pashqyrtuara të i'a japim mundësinë, t'i shqyrtojmë, sikurse poi a japim mundësinë t'i shqyrtojnë këtrye aplikacioneve prej serbisë. Mu, aploslutisht nuk më intereson çka kanë shënuar ata në ato aplikacion. Mu me intereson që divisioni i zgjedhjeve me kry punën e vet me përgjeegjësi të plotë, ashtu siç e ka bërë gjithë. Dhe unë besoj në punën e tyre, sepse këta kanë deshmuar që gjithmonë e kanë bërë punën me profesionalizem. Dhe, nuk kam asnjë pikë dyshimi që nuk kanë me bap rap, mirpo kërkesa ime për t'i shqyrtuar këta aplikacione është se ata kanë aplikuar brenda afatit ligjorë. Ka qënë aplosutisht shumë e veshtirë që me pasë qasje në emailin zyrtarë të KQZ-së dje e pardje. Jo me orë, me ditë. Dhe, kur në momentin që kanë pasë qasje, ata e kanë shfrytëzuar maksimalisht krejt aplikacionet çka i kanë. Dhe, i'a kanë bërë të qartë edhe kryesuesit të divisionit të zgjedhjeve, se këtë po e bëjmë për këtë arsye, s'e s'po mundemi me pasë qasje. Nuk e kanë thënë që jemi duke e bërë në kundërshtim me ligjin, por duke e bërë s'e nuk po kemi mundësi me pasë qasje. Kështuqë unë jam,dy parë aplikacionet. Qoftë këta me email që janë ardhë brenda afatit ligjorë, qoftë këta që kanë ardhë nga Serbia të shqyrtohen nga personeli jonë, që kemi ne divisionin e zgjedhjeve, dhe të shohim a janë votues, a jo. Ajo mbetet në shqyrtimin e fundit.

Valdete Daka: Faleminderit Binak. T'i lejojmë shërbimit votues t'a kryejnë punën e vet, ashtu siç është e paraparë me ligj, pastaj flasim. Vazhdojmë me pikën tjetër....!

Betim Gjoshi: Kryetare, e para unë kisha pasë një lutje për kolegët e mi.nuk është institucion KQZ-ja ku bëhet agjenda partiake. Ëu kisha lutë! Këto ditë, jemi në presion të punës, most ë na shtojnë tensione politike për një grusht vota. I kanë partitë këto punë. E para. E dyta. Mos të marrin detyren e profesionisteve. Mos të bëjnë presion mbi punëtorët e sekretariatit. Dhe mundësishtë le ta thojnë të vertetën, të jenë korrekt. Mos të shpifin për me arsyetu pak autoritet të subjektet që i kanë nominuar...

Binak Vishaj: Duhet me ua dhanë mundësinë me votuar, secilit...Duhet me dhanë autorizim..

Valdete Daka: E kanë autorizimin tashmë, në bazë të ligjit duhet me i shqyrtue të gjitha... Nuk mundemi ne me vendosë për çështje që nuk janë verifikuar...

Binak Vishaj: Nuk mund t'i shqyrtoj më shumë se një imell, nëse ka më shumë anëtarë...tashti, ne le të themi t'i shikojnë edhe nëse ka më shumë... Kryetare, ti mundesh me qitë në votim. E vendosë KQZ-ja. Unë po e propozoj KQZ-në që të të i`u mundesojmë t`a autorizojmë divisionin e zgjedhjeve që të i shqyrtoj këto aplikacione, s`e janë prej diaspores tonë. Janë në afat ligjorë. Gabimi ka qënë i KQZ-së sepse nuk i`u ka ofru mundësi të mira me pasë qasje me apliku. Duhet me i`a japë mundësinë atyre votuesve, në rast se janë votues të ligjshëm me u regjistru.

Valdete Daka: Nuk jemi duke i`a mohuar mundësinë na askujt..

Binak Vishaj: Ëa mohon nëse nuk e autorizon divisionin. Nuk i shqyrton aplikacionin në rast se nuk marrin vendim me i autorizuar këto 4 emaila që janë 700, 100 dhe 30. Unë për këta po propozoj.

Valdete Daka: Ku po shkruan që ska me i shiqu...?

Binak Vishaj: Në faqe 4 kryetare, unë deri qitash e pata propozim, për qita fola.

Valdete Daka: Po mendon që nuk do të shqyrtohen? A po thot dikush që nuk do të shqyrtohen?

Binak Vishaj: Po duhet me autorizu kryetare.

Valdete Daka: Jo nuk duhet me autorizu, ai duhet me i shqyrto gjitha që i ka në bazë të ligjit qysh është e parapame.

Binak Vishaj: Po nuk i shqyrton se ai i ka prej një e-mailit 700, nuk i kqyr aplikacione duhet me autorizu KQZ-ja kryetare.

Valdete Daka: Pse duhet me autorizu KQZ-ja?

Binak Vishaj: Pse duhet, sepse ke marr një vendim ke thën nuk mundet prej një e-mail me ardh ma shumë se sa ato familjare, tash po themi shqyrto janë votues të ligjshëm ju kthen përgjegjen që votuesi është i ligjshëm, nuk janë votues të ligjshëm ju kthen përgjegjen se nuk janë votues të ligjshëm. Kaq. Ideja është që, duhet me shqyrtuar e-mailiin, është personal që ne e kemi dhënë në bazë të qasjes me vendim të KQZ-së që me e mundësu antarëve të familjes , këto janë raste që shënimi votues i, të veqanta i ka piketu si të tilla përshkak se ka shumë aplikacione brenda një e-maili, sepse ka edhe e-maila tjera që ka tre, katër antarë të familjes komform vendimit të KQZ-së i kemi procedu këto janë raste që qfar të bëjmë me ato?

Adnan Rrustemi: A bën, kryetare? E para, sa i përket këtyre, çështjes së dërgesës me 700 aplikacione. Unë kërkova informacione shitesë nga sekretariati, s`e duhet t`i kemi ato informacione, së paku bëhet fjalë për një fenomen të çuditshëm. Janë 700 aplikacione. Sa i përket aplikacioneve nga Serbia, ato janë dërgesë tërësisht e dyshimtë, që duhet me u hetuar. Unë ende s`po degjoj nga shumica prej antarëve asnjë fjalë për dërgesën nga Serbia, ndërkohë merren me mërgatën, madje merren me atë që konsiderohet diskutim politik, a vazhdimisht bëjnë politikë vet ata. Nuk është politikë me folë, cilat kanë qënë dyshimet e KQZ-së? Ku ka qënë pengesa për mërgatën...? Çka me 3 890 aplikacione nga Serbia që n`a kanë ardhë në orë të territ? Dhe, po tentohet madje, që të refuzohen këto 700, s`e unë po kërkoj informacione, s`e edhe mua me duket i çuditshëm si fenomen, e pranohen 3 890 aplikacione të Serbisë. Kjo është për të ardhë keq. Nuk i dihet cilin institucion...

Betim Gjoshi: Kryetare, jemi në të vertetë në zor prej grupeve ekstremiste politike. Që nuk është marre me thanë fshehur, zgjedhjet e vitit 2013 dhe 2014, një grupacion i quajtur srpska e ka keqperdorur këtë vakum ligjorë. Tash janë duke e përdorur grupet tjera të organizuara ekstremiste bashkë me ta. KQZ nuk vendosë për validitetin e tyre, vendosë sherbimi përkatës. Ata i analizojne, i vlersojnë. Qysh I kanë vlerësu këto 11 000 të vlefshme, edhe më tutje vazhdojmë. I kanë kriteret, e kanë rregulloren e vet përpara. Ne po hyjme po e marrin rolin e tyre, për këta nuk flasim na, s`e ne jemi profesionist këtu. Ne nuk na ka dërguar partia këtu me tregu përralla me i`a maru qejfin partisë. Ne jemi ardhur me ruajt institucionin, dhe kemi me ruajt deri ditën e fundit. Kur të vlerëson sherbimi përkatës që duhet me i anulë, i anulon vet. Ne në vend që sot me biseduar si me i shty kapacitetet, me i`a kthyer sa ma shpejtë konfirmimet njerëzve që kanë aplikuar me u regjistruar, s`e po flasim për regjistrim, jo për votim sot. Me i`a mundësu me votu, ne sot po bëjmë politikë, kinse po dojmë me i bë dikuj një favor, ose jo. I`u kisha lutë, mbyllne këtë debat. Le të vazhdon administrata t`a bëjë punën e vet, s`e 10 minuta me i`a hupë kohë këtu, janë të mëdha për ta. As nuk i ka ndaluar kerkush me hapë emaila më shumë, as nuk i ka ndaluar me shtu staf më shumë. E kanë stafin 5 fish më të madhë se në tjera zgjedhje të aprovuar me buxhet të KQZ-së, dhe janë të lirë me vazhdu dhe me qënë në sherbim 24 orë. Po dallon prej të veprave dhe prej fjaleve. Ne nuk jemi të fjaleve. Ne jemi institucion dhe kemi me ruajt. Unë kam percijellë këtu 20-30 parti politike që jane hapë e mbyllë duke bërë agjenda partiake, ne kemi vazhduar me ruajt institucionin dhe kemi me vazhduar me ruajt, sepse këto institucione janë të shtetit të Kosovës. Nuk janë të grupeve të përkohshme që shikojnë me rrenuar atë dhe me përbaltë për interes të vetin, për një grusht vota. Pa marrë parasyshë çfarë etnie i takojnë.

3. Aktivitetet e ZRPP-së

Rekomandim për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatet e tyre, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës.

Miradije Mavriqi: Të nderuar antarë të Komisionit të Zgjedhjeve, zyra deri me 23 maj ka përfunduar procesimin për qërtifikim të 26 subjekteve politike dhe atë nën 19 parti politike, 5

kualicjone dhe 2 nisma qytetare gjithsej 995 kandidatë kjo me përputhje me nenin 15 nen 25 dhe 26 të ligjit për zgjedhje të përzgjedhshme nen 3.4.5 të rregullës zgjedhore të 2013, për çertifikimin e subjekteve politike dhe të kandidatëve të tyre pastaj neni 3 të zgjedhjeve zgjedhore 15/2013 të zgjedhjeve të jashtë zakonshme si dhe duke u bazuar ne planin operacional të miratuar sipas planit operacional, për zgjedhje të parakoshme në kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me 11 qeshorë, subjektet politike kanë plotësuar këto kushte. Të gjitha subjektet politike kanë paguar të gjitha gjobat që janë shqiptuar nga paneli zgjedhor për ankesa dhe parashtrës, pastaj që janë shqiptuar nga KQZ-ja ose nga zyrat e regjistrimit të partive politike. Partit politike të cillat garojnë si kualicione, kanë sjell brenda afatit përcaktues njoftimet mbi lidhjen e atyre kualicioneve. Subjektet politike kanë parashtruar formularin e plotësuar të kërkesës për çertifikim të cillen kryetari ose përfaqësuesi i autorizuar i subjektit politik ka nënshkruar deklaratën e kodit të mirësjelljes, përcaktuar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në rregullën e zgjedhjeve 11/12 2013 në emër të subjektit politik.

Gjithashtu, tha znj. Mavriqi, subjektet politike të cillat kanë aplikuar për çertifikim kanë parashtruar verzionin e shtypur dhe elektronik të listës së kandidatëve për zgjedhjet e nënshkruara nga kryetari apo personi kontaktues, këto janë gjitha kushtet për aplikim po i listoj. Subjektet politike gjithashtu kanë parashtruar formularin e aplikimit për çertifikim të kandidatit dhe formuloheni publikimit financiar të kandidatit të nënshkruar nga kandidati dhe kryetari apo përfaqësuesi i subjektit. Të gjitha këto janë verifikuar, listat e kandidatëve dhe në pajtueshmëri me nenin 29.1 të ligjit 0-073 dhe nenit 9 të ligjit për zgjedhje. Andaj asnjë kandidat besojmë që nuk është propozur të jëtë kandidat për pos një subjekti politik, dhe subjektet politike ne listën e kandidatëve kanë respektu gjithashtu kodet gjinore e përcaktuar me nenin 27 të ligjit mbi zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Subjekti politik në pajtueshmëri me nenin 15.7 të ligjit mbi zgjedhjet e përgjithshme nenit 3.4 të rregullës zgjedhore ka dërzuar 1.000 nënshkrime të përkrahësve dhe në pajtueshmëri me nenin 23 ka derzuar 2.000 euro, dëftesën e pagesës paguar prej 2.000 eurove për të plotësuar kërkesën ligjore. Zyra, rekomandon të çertifikohen të listuara te secili subjekt politik nga faqja dhjetë e këtij rekomandimi, ju faleminderit.

Betim Gjoshi: Fillimisht një qështje para se me votu dmth është mirë përveq qështjes që po e miratojmë sot është mirë mi njoftu të gjithë palët e interesuara qdo dyshim për ndonjë personë që kanë i cili nuk është në përshtatshmëri në lidhje me ligjin në Kosovë që ka ndaj tij vepra penale që ka kryer gjatë jëtës së tij apo siq e parasheh ligji në keto 3 vitet e fundit ta ankimojmë brenda 24 orëve në qëlimë që të kemi një listë sa më të pastëer të kandidatëve për deputet në fakt deputeteve ne Kuvendin e Kosovës, ne të gjithë e dimë që ne e marrim nga një zotim prej tyre që janë në përputhje me ligjin por jot ë gjithë kandidatët mund ti njohim aq më pak kur kemi 26 subjekte të komuniteteve të ndryshme kështu që qytetaret e kanë mundësinë ne do ti publikojnë menjëherë pas miratimit kanë mundësi 24 orë dhe të gjitha palët e interesuara t'i arkimojnë këta persona kanë precedent penal me qëllim që ne të kemi një parlament sa më të pastër nga elementet tilla. Atëherë, e kemi nenin 29 të ligjit mbi zgjedhjet të përgjithshme i cili, i parasheh kushtet e përshtatshmërisë për secilin kandidat dhe në pikën P të nenit 29 është ë parapër që kandidati duhet të mos jëtë i shpallur fajtorë për vepër penale me vendim të gjykatës në 3 vitet e fundit në mes të edhe shumë kushteve të tjera, pra, të gjithë ata që dinë se ndonjë

kandidat ka qenë i dënuar me vendim të plotëfuqishëm të gjykatave të Republikës së Kosovës në 3 vitet e fundit mundë ta bëjë ankesën para zërit në afat prej 24 orëve nga momenti i shpalljes së këtyre listave. Unë, prita po e ngret zyra ose që dikush, ne i kemi disa ankësa zyrtare që na u kanë drejtuar neve në lidhje me subjektet politike të komuniteteve, ne siq e dimë dmth 22 nga subjektet politike garojnë për vendet e rezervuar në emër të komuniteteve të caktuara edhe ka pasur një anëkesë me emër me mbiemër për persona të caktuar të cilët kanë hyrë me shumicë kanë garuar në emër të komuniteteve për vendet e rezervuar, kjo dmth rrezikon frymën e tolerancës në vendin tonë, ju kisha kërkuar që sot ta miratojmë këto 4 subjete shumicë, ti miratojmë të gjitha subjektet politike pasi i kanë plotësuar kushtet por brenda 24 orëve zyrat në bashkpunim me monimentin e statistikave të Kosovës edhe subjektet përkatëse të vërtetoj përkatësinë e tyre etnike që të mos kemi problem në të ardhmen kur ne konstohet Kuvendi i Kosovës, ne e dimë që kuotat janë të ndryshme dmth për me u fut në Kuvendin e Kosovës, nëse një antar shumicë i duhen 10.000 në emër të pakicave mund të hyjnë me 200 vota siq kemi pasur në të kaluarën edhe kjo do të sillte një disbalanc në Kuvendin e Kosovës dhe realisht një mashtrim dhe në kundërshtim edhe me ligjin, neni 119 kujtoj të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, por edhe Kushtetutën e Kosovës ku e parashe ndarjen e vendeve për këto pjesë të komuniteteve, kështu që unë besoj që edhe kolegët e tjerë e mbështesin këtë proceduralisht ndoshta mund të na sjell disa vonesa deri në para ditën e nesërme që ti miratojmë edhe kandidatët. Faleminderit...

Bajram Ljatifi: E falenderoj zyren për punën e bërë, por edhe kolegët në propozimin që të certifikohen të gjitha subjektet politike, por kandidatët, veçanërisht të komuniteteve të vërtetohen në afat prej 24 orë, dhe ata, të mos certifikohen sot...Na kanë ardhur lista të dyshimta, dhe anomali të këtilla të mos tolerohen, dhe sipas nenit 64 të Kushtetutes, vendet e garantuara mund ti verifikoj vetëm KQZ. Kërkoj që zyra ti respektoj afatet...

Valdete Daka: Ndoshta kishte me qenë ne ti qertifikojmë partit politike të komunitetit shumicë, ndërkaq këto që janë të komunitetit pakicë ti qertifikojmë kandidatët e tyre nesër. Po partitë politike sot të gjitha të cilat i plotësojnë kushtet, ndërkaq listat e kandidatëve të partive të komunitetit jo shumicë që jetojnë në Kosovë, ti qertifikojmë nesër, qoftë se pajtoheni.

Binak Vishaj: Ta përcaktojmë afatin 24 orë...Nuk janë shumë aty, 130-140 kandidat që kanë, për një kohë shumë të shkurt Enti i Statistikave mundet me kthi përgjegjen se cila është përkatësia e tyre kombëtare.

Valdete Daka: Atëhere a pajtoheni me këtë propozim që sot t'i certifikojmë të gjitha subjektet politike, si dhe kandidatet e subjekteve politike shumicë, ndërkaq të kandidateve joshumicë t'i certifikojmë nesër në ora 17. Kush është për këtë propozim? Faleminderit! Kush është kundër? Kush apstenon?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan me vota unanime këtë propozim.

Valdete Daka: Tani, po fillojmë me certifikimin e subjekteve politike:

Kush është që të certifikohet subjekti politik “FJALA”, me 110 kandidat? Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të certifikohet subjekti politik “G J EROMENDJE ALTERNATIVA”. Kandidatët e këtij subjekti i lëmë të paçertifikuar, por e certifikojmë vetëm subjektin politik. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan me vota unanime certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është për që të certifikohet subjekti politik “GI ZA PROSPERITET KOSOVA”. Vetëm subjekti. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të certifikohet subjekti politik “GRAÇANSJA INICIATIVA GORE”? Pra, vetëm subjekti. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është për që të certifikohet “GRAÇANSKA INICJATIVA SRSPKA LISTA”? Vetëm subjekti.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të certifikohet “INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS”? Vetëm subjekti politik.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të certifikohet “JEDINSTVE GORANSKA PARTIA”? Vetëm subjekti politik.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të certifikohet subjekti politik “KUALICIA VAKAT” ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të certifikohet subjekti politik “KOSOVA DEMOKRATIK TURK PARTISI”?
Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të certifikohet subjekti politik “KOSOVA TURK ADALET PARTISI” ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të certifikohet subjekti politik “KOSOVA KI NEVI ROMANI PARTIA”? Vetëm subjekti...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të çertifikohet subjekti politik “NA PRED NA SNAGA KOSOVA” ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të çertifikohet subjekti politik “PARTIA DEMOKRATIKE E HASHKALINJËVE TË KOSOVËS” ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të çertifikohet subjekti politik “PARTIA DEMOKRATIKE E UNITETIT” ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të çertifikohet subjekti politik “PARTIA E HASHKALINJËVE TË KOSOVËS PËR INTEGRIM” ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të çertifikohet subjekti politik “PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE” ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të çertifikohet subjekti politik “PARTIA KOSOVSKI SRPSKA AKTIVNA GRAĐANSKA INICIATIVA” ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është për që të çertifikohet subjekti politik “POKRET ZA GORA” ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është për që të çertifikohet faleminderit, subjekti politik “PROGRESIVNA DEMOKRATSKA STRANKA” ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të çertifikohet “LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS” ALEANCA KOSOVA E RE” me 110 kandidat ?

Sami Hamiti: Po kryetare , tek një kandidat duhet te bëhet një pëemirsim, të bëhet me ngjyra atje këtu nuk është po më dokumenta jo , jo te numri 45 deputetja Zogaj Gashi është vetëm Gashi dhe të bëhet siç është në regjistër e ri Zogaj Gashi numër 45, Zogaj Gashi është Besa Zogaj Gashi këtu është vetëm Besa Gashi, është në regjistër.

Valdete Daka: Kush është pra që të çertifikohet me këtë ndryshim, dhe me 110 kandidatë...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të çertifikohet “NOVA DEMOKRACA STRANKA” ? Vetëm partia.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të qertifikohet” LËVIZJA VETËVENDOSJE” me 110 kandidat...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të qertifikohet “PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS”, “ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS”, “NISMA PËR KOSOVEN”, ”PARTIA E DREJTËSISË”, “LËVIZJA PËR BASHKIM”, “PARTIA SHQIPËTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS”, “PARTIA KONZERVATORE E KOSOVËS”, “ALTERNATIVA DEMOKRATIKE E KOSOVËS”. “REPUBLIKANET E KOSOVËS”, “PARTIA E BALLIT”, “PARTIA SOCIALDEMOKRATE” DHE “BALLI KOMBËTARË I KOSOVËS” me 110 kandidat.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Kush është që të qertifikohet subjekti “STRANKA DEMOKRACKIA AKCIE BOSNJACKA STRANKA DEMOKRACIA AKCIJA KOSOVA”? Vetëm subjekti.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e këtij subjekti politik.

Valdete Daka: A ka ndokush ndonjë pyetje...?

Eshref Vishaj: Te subjekti im, është një gabim te kandidati Isa Xhemajlaj, prat e mbiemri.... Kam intervenuar edhe te zyra...por, nuk është përmirësuar, le të përmirësohet

Valdete Daka: Atëherë, vendimet draftëvendimet përmirësohen sipas vendimit të sotëm. Nderkaq në ndërkohë për subjektet politike të cilat nuk janë qertifikuar kandidatë të kërkohet nga enti i statistikave përkatësia kombëtare e tyre me qenë se, kemi mundësi të dyshimeve, vazhdojmë me pikën tjetër ajo është këshilli për buxhet .

Betim Gjoshi: Ju lutem, është mirë me kontakti përvëq entit statistikave sot ëdhë partit edhe subjektet politike të cilat i kanë kërkua kandidatë që nashta me vullnet e ndryshojne ndonjë që mos me na hup kohë sepse I duhet pëe me na tregu qeshtjen e kësaj. Faleminderit vazhdojmë me këshillin pëe buxhet .

4.Raport i Këshillave të KQZ-së

a.Këshilli Për Buxhet

Shqyrtimi i kërkesës për transferin te mjeteve nga programi i zgjedhjeve;

Shqyrtimi për mbushje të telefonisë mobile gjatë procesit zgjedhorë;

Ilir Gashi: Ne, sot si këshill i buxhetit faktikishtë kemi trajtuar dy shkresa të ardhur nga sekretariati kryesisht e para është kërkesa për transfer të mjeteve të brenda në programin zgjedhor , në buxhet është kërkuar të sigurohen mjete buxhetore për akumulim brenda vendit në programin e zgjedhjeve nuk ka pasur siq dihet mjete buxhetore destinuar për akumulim . me qëllim të përmbushjes të kesaj kërkesë , propozojmë transferimin e buxhetit në këtë program brenda kategoris ekonomike mallrave dhe shërbimeve , përkatsishtë nga nje nën program , në nën programin tjetër. Propozimi është në pajtim me paragrafin 3 te nenit 18 te ligjit 05L125 dhe nuk është kaluar shuma e paraparë sipas ligjit prej 25% andaj ne si këshill kemi miratuar dhe kërkojme nga ju që te miratohet , ju faleminderit.

Gjithashtu, tha z. Gashi, e kemi trajtuar edhe një shkresë tjetër si kërkesë të cilën këshilli e ka miratu dhe e ka prur para komisionit që si kërkesë për të miratuar, është në kuadër të aprovuar të parakohshme në kuvendin e Kosovës, ashtu sipas praktikave të deri me tashme dhe kërkesave dhe nevojave që ka sekretariati dhe nevojave në këtë proces, e është kërkuar që të miratohet kërkesa për mbushje për procesin zgjedhorë të menagjeret në qendrat të votimit, dhe ekipet tjera mobile, mbushjet elektronike janë për muajin maj dhe qeshorë dhe në bugjetin total 9890 euro.

5. Shqyrtimi i rekomandimit të DOZ-it për rritjen e numrit të votuesve në vendvotim

Enis Halimi: Faliminderit. Ky, është një propozim që la ardhë nga shërbimit të votuesëve përkatësisht nga departamenti të operacioneve zgjedhore, është e zakonshme që sipas ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në vendë votim nuk kalon mbrenda 750 votues tashë që jemi në fazën finale të krijimit të listës së votuesëve të planifikimit të shtyllave të vendvotimit të prodhimit dhe fletë votim. Dhe shërndarja e tyre duke u bazuar në vendimet e marr nga zgjedhjet e kaluara i nje propozim i departamentit të operacioneve zgjedhore është qëllimi i votuesëve, propozojmë pra numri i votuesëve nga 750 për vendë votim të rritet në 950 pra sipas kesaj profmulës të paraqitet në tabelen në faqen vijuese.

Valdete Daka: Kush është për këtë propozim ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë propozim.

Ilir Gashi: Ky raport, dëshmon edhe anën e kundërt e asaj që tha kolegu ma herët edhe pse e tha para medimeve edhe është vetum i pari i këti këshilli i cili e din për punen të cilin e kemi bërë deri më tashmë. Këshilli për informim publik ka mbajtur për 3 takime deri me sod , në takimin e parë kanë bërë njoftimin për afatin e qertifikimit të subjekteve politike njoftimin e afatëve për akreditim të vëzhguesëve dhe njoftimin e aplikim të votuesëve për

regjistrim për operacionet e votimit përmes postës. Njoftimet janë transmetu në RTK , janë publiku në faqën e kqz-s dhe janë të shpërndarë në rrjetet të tjera sociale takimin e dytë. Kemi bërë njoftimin për periudhën e shërbimit votues njoftimin për themelimin të qendrave të reja njoftimin për periudhën e kundërshtimit dhe të konfirmimit, njoftimi për fazën e shërbimit votuesëve të transmetuar në RTK, gjithashtu është publikuar në ëeb faq, e KQZ-së dhe faqet e komunave dhe shpërndarjen e rrjetëve sociale,ndërsa njoftimi për themelimin e qendrave të reja të vendvotimit është publiku në ëeb faqën e KQZ-së dhe ëeb faqëve të komunave, sod kemi majtë po ashtut takimin e radhës ku kemi bërë miratimin për njoftim për regjistrim për votim mes ekipeve mobile të personave me nevoja të veqanta. Për njoftimin se si të plotësohet dhe të votohet përmes, OVPP-ve si dhe njoftimin per hapat në vendë votim dhe udhëzuesin për vëzhguesit. Të njëjtat, këto të cilat sod i kemi votu dhe miratuar të transpentoher dhe të pubikuar sipas afatëve të miratuar në planin operacional qe e kan miratu KQZ-ja, e po ashtu, ju njoftojmë që së shpejti do të fillojmë edhe me punën e informimit publik lidhur me punën i cili do ta merrë përsipër këtë qëshjtje ju faliminderit...

6. Zëvendësimi dhe plotësimi i anëtarëve të KKZ-ve

Enis Halimi: Para disa ditësh, i kemi emëru disa nga antarët e komisioneve që ata kan fillu me punë në të gjitha komunat por ajo që vërehet është në disa raste qe kat bëje me terheqjen e tyre nga detyra për nga arsyjet e ndryshme dhe plotësimi i vendëve që herën e parë pra kanë munguar si të tilla plotësimin dhe zavendësimin të komunave e kemi edhe listën pëerpara dhe po e përserisë qe 8 zëvendësimet sipas komunave dhe 2 plotësime sipas që skan qenë herën e parë dhe atëhere uroj që edhe këto ti miratoni qe nga sod të fillojnë...

Valdete Daka: A ka dikush ndonje pyetje për kryeshefin lidhur me këto zavendësime...?

Betim Gjoshi: Po kryetare..., ky po thot që për herë të parë qe qka nënkupton kjo për herë të parë, dmth a po zavendësojm apo krijojmë shtesë per shtyp per komunal zgjedhor, po e rrisim veq ta kemi të qartë...! (Shpjegime lidhur me këtë pikë, dha kryeshefi E.H.)

Anëtarët e KQz-së, miratuan zëvendësimin dhe plotësimin e anëtarëve të KKZ-ve me një votë abstenimi (Betim Gjoshi).

Valdete Daka: Edhe Erxhani e pati një kërkesë...! Urdhëro...?

Ercan Spat: Faliminderit kryetare. Edhe jashtë të këti takimi, u mundova që me ju informuar edhe sekretariatit, por edhe kolegët e mi të nderuar çshtja ka të bej me një qendër votimi me një lagje të prizrenit në lagjen “Kurir”, në shkollën “Motrat Qiriazit”. Në vazhdimësi në të gjitha zgjedhjet, këto që janë të parakohshme, është ky problem...Banorët e lagjës

vendëvotimet po i gjejnë në pjesën rurale të Prizrenit, në lagjet ma të largëta të Prizrenit. Jjan shumë raste, po duke mos e zgjatur shumë, në rastin konkret nuk dua që ta besojë se dikush e ka bërë me qëllim, jam i sigurtë se nuk kanë pse ta bëjnë por, kërkoj të përmissohet ky defekt dhe, unë dua që Sekretariati të dal sa më shpejtë me një zgjedhje...

Betim Gjoshi: Jashtë komunes, nuk do të zhvendoset askush që është në regjistrin civil, a i ndahet ndokush i familjes së ai, ka nxjerr ndokush dokumentat apo leternjoftimin apo pasaportën në qat vendë del qendra e votimit, e dyta, nuk është vetëm në Prizren janë në krejt vendet urbane kjo është si mos rezultat i punës së KKZ dhe tonat se na e dim se si procedurë të bëhet percaktimi manual votuesëve këtë rast nuk është kryer percakimi manual votuesëve, e dyta nuk janë shikuar a kanë kapacitete me shtu numrin e vendë votimit kur janë kriju qendrat dhe janë dërguar më tutje për me votue...Këto, janë fenomene në kemi pasur tanë ditën dhe e pardje ankesa për prishtinë se janë vendosur prej dardanisë të xhamia e lllapit ku ka pasur ndonjë vend si psh ku ka pasur naj shkoll që ka gjetur naj vend të lir si hazër i ka bartë, d.mth që ky është problem që duhet me i shiku, d.mth. i ka këto problem dhe është mirë me majtë qëndrim nëpër krejt qendrat urbane...Avokimi i votuesëve, e konkretisht prej zyrtarëve tanë komunal në aspektin manual, duke i trajtuar rrugë për rrugë, e vendë për vendë..., e ata nuk e kanë kryer punën e vetë, dhe është mirë me krye sa ka mundësi ende....

Pwr KQZ

Valdete Daka, kryetare
